

---

Data 29.05.2026

## PROCESVERBAL

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** Përmirësimi i transportit lokal dhe urban me ndërhyrje në rrugë dhe trotuare, “Lot 8-Sistemimi urban i zonës së rindërtimit në lagjen nr.4 në qytetin e Laçit.”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** 45000000-7.

Fondi limit: 39,650,488 Lekë pa TVSH. Programi buxhetor GOA, Kodi 24AE801.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

#### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

##### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

##### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **financiare 2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontrates në procedurën e prokurimit..

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/b e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:



---

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Pika 2.3.1/a**, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore e situacionit perfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të ulët dhe kufirin e lartë monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve. Licenca duhet te permbajë kategoritë e punimeve të kontratës si me poshtë:

#### **PER PUNIMET E PERGJITHSHME TE NDERTIMIT**

|      |   |  |
|------|---|--|
| NP 1 | A | Punime gërmimi në tokë.  |
| NP 4 | B | Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. |
| NP 7 | A | Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.              |

|       |   |  |
|-------|---|--|
| NP 11 | A | Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. |
| NP 12 | A | Punime të inxhinierisë së mjedisit.  |

#### PER PUNIMET SPECIALE TE NDERTIMIT

|       |   |   |
|-------|---|---|
| NS 1  | A | Punime për prishjen e ndërtimeve                                |
| NS 6  | A | Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.                              |
| NS 8  | A | Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri. |
| NS 18 | A | Punime topogjeodezike   |

*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008).*

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

#### ARGUMENTIMI LICENCAT

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

| Kategoria e kërkuar |   | Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës | Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse   | Niveli i klasifikimit sipas kategorisë përkatëse | Vlera e punimeve, sipas kategorisë përkatëse |
|---------------------|---|--|--|--|--|
| NP 1                | A | Punime gërmimi në tokë.                                | Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , në kanale gjeresi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet<br>Gërmim me krahe në seksion të detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, tokë e zak.<br>Transport dheu me auto deri 5.0 km<br>Gërmim e transport dheu kat I-re me skreper, L=100m dhe V=6~6.5m <sup>3</sup><br>Mbushje me material të gërmuar në trupin e rruges, përhapur e ngjeshur me makineri | 0-20 milion lekë                                 | 1,457,704                                    |

|      |   |  |   |                      |            |
|------|---|--|---|----------------------|------------|
| NP 4 | B | Rrugë,<br>autostrada,<br>mbikalime,<br>hekurudha,<br>tramvai,<br>metro, pista<br>aeroportuale. | <p>Shtrese stabilizant t=15cm<br/> Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, përhapur e ngjeshur me makineri<br/> Shtrese zhavor lumi t=10cm<br/> F.V. Bordura betoni 15x35 cm<br/> Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka<br/> Struktura monolite betoni C 20/25<br/> Struktura monolite betoni C 16/20<br/> Parmak me lende druri<br/> Boje vaji sipërfaqe druri<br/> Shtrese rere<br/> Shtrese betoni C 12/15<br/> Nenshtrese zhavori<br/> Shtrese derrasa FM 2.5cm<br/> Mbushje me zhavorr pas mureve<br/> Ndertim puseta betoni H=2.5-3m, D=1m + kapak gize<br/> Pusete kontrolli 1.5x1.5x1 m<br/> F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm<br/> F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm<br/> F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm<br/> F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm<br/> Puse kontrolli 1x1x1.5m<br/> Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri<br/> Shtrese binderi me granil gur kave,5cm,me makineri<br/> Furnizim, vendosje tuba plastmasi ø 63<br/> F.V. Tuba metalik D=63mm<br/> Pusete shiu 40 x 70, h ~ 150 cm, me kapak kompozit<br/> F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm (perfshire reren rreth tubit) (KUSH)<br/> F.v. Tabele tetekëndore "shërbimi"<br/> F.V. Parale<br/> F.V.Stola<br/> F.V.Lodra ne natyre (Lisharese, lekundes, tra)<br/> F.V.Kosha mbeturinash te vegjel (ne largesi ~50m)</p> | 21-50<br>milion lekë | 28,010,856 |
| NP 7 | A | Ujësjetës, gazsjellës, vajsjetës, vepra kullimi e vaditje.                                     | <p>F.V. Hidrante Ø 80 mm<br/> F.V. Tuba e rakorderi ujesjetesi PE d=63mm, Pn 16<br/> F.V. Tuba e rakorderi ujesjetesi PE d=160mm, t = 11.8 mm, Pn 10<br/> F.V. Tuba e rakorderi ujesjetesi PE d=90mm, Pn 16<br/> F.V. Tuba e rakorderi ujesjetesi PE d=125mm, Pn 16<br/> F.V. Tuba e rakorderi ujesjetesi PE d=110mm, Pn 16<br/> F.V Tuba e rakorderi ujesjetesi PE d=140mm, t = 11.8 mm, PN 10<br/> F.V. saracineska gize me flanaxha, PN 16 bar, DN160<br/> F.V. Adaptor DN 160<br/> F.V. Xhunto ø63, PN 10<br/> F.V. TEE PE 100 ø90-63-160mm<br/> F.V. TEE PE 100 ø90-110-125mm<br/> F.V.Manikot ø63, PN 10<br/> F.V. Manikot ø160, PN 10<br/> F.V. Manikot ø90, PN 10<br/> F.V. Tape PE/NB DN 63 PN 10<br/> F.V. Tape PE/NB DN 110 PN 10<br/> F.V. Brryl gize 90°, me flanaxha, /DN90 Pn16</p>  | 0-20 milion<br>lekë  | 1,146,944  |

|          |   |   |  |                  |           |
|----------|---|---|--|------------------|-----------|
| NP<br>11 | A | Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorë ve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. | F.V. Percjellesa Cu te izoluar me gome per ndricim, ne tubot e vendosur me pare, sexion 16mm2<br>F.V. Ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 3x10mm2<br>F.V. Percjellesa Cu te izoluar me gome, per ndricim, ne izolator, sexion 2.5mm2<br>F.V. Kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement<br>F.V. Shtylla dekorative dy degeshe per ndricim, H=8m<br>F.V. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086<br>F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m<br>F.V. Shirit sinjalizimi per kablllo 20 kv<br>F.V. Tub fleksibel me dy shtresa D=90mm<br>F.V. Tub metalik D=110mm<br>FV Puseta betoni me Kapak Gize 30x30x30cm<br>F.V.ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar,5x10mm2<br>F.V.ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar,4x6mm2<br>F V shtylla metalike per ndricim, H=8-9m, d=160mm<br>F.V Ndricules LED 110 w perfshi te gjithe aksesoret e nevojshem | 0-20 milion lekë | 3,430,214 |
| NP<br>12 | A | Punime të inxhinierisë së mjedisit.   | F.V. Dhe humusore<br>Mbjellje bari ne skarpat<br>F.V. Fidane Peme dekorative<br>F.V. Fidane shkurre dekorative "Oleander"<br>F.V. Mbjellje peme dekorative Bli 16-18cm ne trotuar, (cdo 6m)<br>F.V. Fidane bime kacavjerrese   | 0-20 milion lekë | 724,919   |
|          |   |   |  |                  |           |
| NS 1     | A | Punime për prishjen e ndërtimeve  | Prishje shtresa betoni<br>Prishje mur blloqe betoni  | 0-20 milion lekë | 193,745   |
| NS 6     | A | Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.  | F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm<br>F.V. Tabela trekendore normal me A = 90<br>Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm.<br>Bikoponente (paste)<br>Vijezimet e kalimit te kembesoreve. Bikomponente (paste)  | 0-20 milion lekë | 1,347,265 |
| NS 8     | A | Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.   | F.V. Konstruksione metalike te thjeshta.<br>F.V. Konstruksione metalike te perbera<br>Pedane druri (binare+derrase+parket)<br>Ura druri. Ndertimi i strukturtes mbajttese  | 0-20 milion lekë | 2,203,565 |
| NS<br>18 | A | Punime topogjeodezike   | Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik   | 0-20 milion lekë | -         |

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të ketë stafin drejtues teknik të punësuar dhe regjistruar si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Ne baze të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me one të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtesisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikepamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarevajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin e objektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

**Punimet apo veprimtarite konkrete per te cilat kerkohet ekspertiza e tyre profesionale jane:**

|                       |  |
|-----------------------|--|
| Inxhinier Ndërtimi    | Punime gjermimi në tokë.<br>Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.<br>Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.<br>Punime për prishjen e ndërtimeve. |
| Inxhinier Elektrik    | Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike  |
| Inxhinier Mekanik     | Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.<br>Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.  |
| Inxhinier Hidroteknik | Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje.   |
| Inxhinier Mjediti     | Punime të inxhinierisë së mjeditit.  |
| Inxhinier Gjeodet     | Punime topogjeodezike  |

**2.3.4. Operatori ekonomik duhet te disponoje punonjes te specializuar/te kualifikuar, si me poshte:**

1(nje) punonjes te disponoje certifikate si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier". Per te deshmuar permbushjen e ketij kriteri, operatorët ekonomike duhet te paraqese:

- Diplome/certifikate
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë prezencën në objekt të personelit të mesipër dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zevendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose me të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave perkatëse. Në rast perseritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës.

\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomike të deshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mesipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjeditit". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjejë kurse formimi perkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e perkohshëm ose të levizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikeqyrjes. Operatori/et ekonomik/e, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe

dokumentat perkatase lidhur me ndikimin ne mjedis dhe rehabilitimit te mjedisit, per raste ndotjesh sic; parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e pergjithshme per garantimin e mbrojtjes ne nje nivel te larte te mjedisit jane detyrim ligjor per cdo subjekt tregtar person fizik apo juridik per parandalimin dhe pakesimin e rreziqeve ndaj jetes e shendetit te njeriut, sigurimin dhe permiresimin e cilesise se jetes, ne dobi te brezave te sotem dhe te ardhshem, si dhe sigurimin e kushteve per zhvillimin e qendrueshem te vendit. Garantimi i ekspertizes se mbrojtjes nga cdo rrezik dhe te papritur ne pune dhe dokumentat perkatase te personave pergjegjes i sherbejne autoritetit per te krijuar bindjen dhe besueshmeri per realizimin e kontrates.

Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune rekomandohet te jete ne kantier per minimizimin e aksidenteve ne pune.

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e punimeve objekt kontrate duhet te disponoje fuqi punetore prej minimalisht 9 persona per periudhen, 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave e vertetuar kjo me:

- Vertetim te leshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj, per periudhen 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave.

\* Kriteri konsiderohet i permbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

#### **ARGUMENTIMI NR PUNONJESVE**

Ne percaktimin e numrit te punonjesve specialisti i fushes ka bere nje analize bazuar tek faktoret, si volumet dhe kategorite e punimeve, kualifikimi i punonjesve, grafiku i punimeve, zerat e punimeve dhe oret e punes dhe pagen minimale te lejuar qe duhen per te permbushur kontratesn. Numri i punonjesve dhe qendrueshmeria e tyre ne pune me koheshtrirje (3 mujore nga momenti i hapjes, tregon besueshmeri per autoritetin qe, operatori do te permbushe kontraten. Dëshmia e kerkuar per numrin e fuqise punetore te operatorit ekonomik e nevojshme per ekzekutimin e objektit te kontrates, eshte dokument qe verteton kapacitetin teknik dhe profesional te operatorit, persa kohe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjesve ne regjistrin e sigurimeve eshte nje detyrim ligjor i punedhenesit e parashikuar nga Kadi i Punes, per rrjedhoje vertetimi i leshuar nga administrata tatimore e shoqeruara me listpagesat me kete koheshtrirje eshte dokument vertetues per qendrueshmerine e te punesuarve, pervojen e tyre, dhe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Punesimi i nje numri te caktuar, pervec; besueshmerise se operatoreve ekonomik, si nje nga kerkesat themelore te kualifikimit, perpiqet te kufizojte edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit ne tregun e punes. Po ashtu eshte nje tregues i kualifikimit dhe eksperiences qe duhet te kete kjo kategori e punonjesve. Vendosja e kriterit duke perfshire dhe stafin teknik, eshte ne perputhje me volumin e punes, natyren dhe terrenin ku do te kryhen punimet. Kriteri per kualifikim eshte vendosur qe t'i sherbeje autoritetit per te njohur gjendjen e kapaciteteve te operatoreve te cilet nepermjet dokumentacionit te vertetojne se zoterojne, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshem, si dhe kapacitetet organizative, gjithcka rie funksion te realizimit me sukses te kontrates.

Analizat teknike jane bazuar ne VKM nr. 216, date 13.4.2023 "Per krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar perinformatizimin e manualit te cmimeve per zerat e punimeve ne ndertim" Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos (material, punetori, makineri, transport) zeri fuqi punetore ze rreth 20% te kosos.

Total ore pune = 15,886 ore (referuar oreve te punes per cdo ze pune te preventivit)

Ore/1 dite pune = 8 ore

Total Dite pune puntori = 15,886 ore/8 ore= 1,986 dite pune

Dite pune gjithesej= 10 muaj (sipas grafikut te punimeve) \* 22 dite/muaj= 220 dite pune

Numri i fuqise puntore = 1,986 dite / 220 dite = 9 punetore afersisht.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ne pronesi ose qira:

| Nr | Emri i mjetit/pajisjes                                | Njësi | Sasia | Statusi                |
|----|---|-------|-------|------------------------|
| 1  | Eskavator me Goma                                     | Copë  | 1     | Ne pronesi ose me qera |
| 2  | Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës deri 20 Ton | Copë  | 1     | Ne pronesi ose me qera |
| 3  | Kamioncine  | Copë  | 1     | Ne pronesi ose me qera |
| 4  | Kamion me Vinc  | Copë  | 1     | Ne pronesi ose me qera |
| 5  | Fadroma   | Copë  | 1     | Ne pronesi ose me qera |
| 6  | Autobot Uji   | Copë  | 1     | Ne pronesi ose me qera |
| 7  | Autobetoniere   | Copë  | 1     | Ne pronesi ose me qera |
| 8  | Autopompe   | Copë  | 1     | Ne pronesi ose me qera |
| 9  | Gjenerator  | Copë  | 1     | Ne pronesi ose me qera |
| 10 | Vibrator  | Copë  | 2     | Ne pronesi ose me qera |
| 11 | Betoniere min 0.5 m <sup>3</sup>                      | Copë  | 2     | Ne pronesi ose me qera |
| 12 | Minieskavator   | Copë  | 1     | Ne pronesi ose me qera |
| 13 | Greider   | Copë  | 1     | Ne pronesi ose me qera |
| 14 | Asfaltoshtruese                                       | Copë  | 1     | Ne pronesi ose me qera |
| 15 | Autobitumatrice                                       | Copë  | 1     | Ne pronesi ose me qera |
| 16 | Rul Gome-Hekur  | Copë  | 1     | Ne pronesi ose me qera |
| 17 | Rul Hekur-Hekur                                       | Copë  | 1     | Ne pronesi ose me qera |

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet te jene te angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira, do të paraqiten keto dokumenta:

- Për mjetet ne pronesi (që shënohen në regjistra publikë), duhet të paraqiten;- dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), -plus certifikaten e kontrollit teknik, -siguracionin e mjetit (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore.
- Për mjetet e siguruara me qira, duhet të paraqiten; -dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), vertetimin e pageses

per taksat vjetore, kontrata e qirase e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.

- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimi, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".*

#### **ARGUMENTIMI MJETET**

Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c; dhe 6/d, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane fuqine minimale punetore, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten.

Per te percaktuar numrin e mjeteve/makinerive te nevojshme per realizimin e kontrates, jane hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit te fushes bazuar ne VKM nr. 629, date 15.7.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, date 26.10.2018).

| <b>Nr</b> | <b>Emri i mjetit/pajisjes</b>                         | <b>Njësi</b> | <b>Sasia</b> | <b>Emërtimi i punimeve</b>  |
|-----------|---|--------------|--------------|---|
| 1         | Eskavator me Goma                                     | Copë         | 1            | Punime gërmimi në tokë.<br>Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.<br>Punime për prishjen e ndërtimeve.<br>Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.<br>Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje.<br>Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N. |
| 2         | Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës deri 20 Ton | Copë         | 1            |   |
| 3         | Kamioncine  | Copë         | 1            |   |
| 4         | Kamion me Vinc  | Copë         | 1            |   |
| 5         | Fadroma   | Copë         | 1            |   |
| 6         | Autobot Uji   | Copë         | 1            |   |
| 7         | Autobetoniere   | Copë         | 1            |   |
| 8         | Autopompe   | Copë         | 1            |   |
| 9         | Gjenerator  | Copë         | 1            |   |
| 10        | Vibrator  | Copë         | 2            |   |
| 11        | Betoniere min 0.5 m³                                  | Copë         | 2            |   |
| 12        | Minieskavator   | Copë         | 1            |   |

|    |                 |      |   |                                     |
|----|-----------------|------|---|-------------------------------------|
| 13 | Greider         | Copë | 1 | Punime të inxhinierisë së mjedisit. |
| 14 | Asfaltoshtruese | Copë | 1 |                                     |
| 15 | Autobitumatrice | Copë | 1 |                                     |
| 16 | Rul Gome-Hekur  | Copë | 1 |                                     |
| 17 | Rul Hekur-Hekur | Copë | 1 |                                     |

### 2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (ekuivalent)
- ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (ekuivalent)
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (ekuivalent)

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH, etj., mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit nr. 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

### **Shënim:**

#### ***Mbi mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera***

*Në mbështetje të nenit 84, pika 7, të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 90, pika 6, të VKM nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë **nuk mund të***

**mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera për kriteret që lidhen drejtpërdrejtë me realizimin e proceseve kryesore të kontratës, konkretisht:**

- *përvojën e mëparshme të ngjashme;*
- *personelin/stafin kryesor;*
- *fuqinë punëtore minimale;*
- *licencat profesionale të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate.*

*Këto kapacitete konsiderohen thelbësore për realizimin e kontratës, pasi lidhen drejtpërdrejt me organizimin e punimeve, koordinimin e zbatimit në kantier, përputhshmërinë me specifikimet teknike dhe kërkesat ligjore, si dhe kontrollin e cilësisë dhe sigurisë gjatë realizimit të punimeve objekt kontrate. Autoriteti Kontraktor vlerëson se mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera për këto kritere mund të cenojë realizimin efektiv dhe të besueshëm të kontratës. Për këtë arsye, këto kapacitete duhet të disponohen dhe të angazhohen drejtpërdrejtë nga operatori ekonomik ose anëtari përkatës i BOE që do të realizojë punimet, me qëllim garantimin e përgjegjshmërisë, cilësisë së ekzekutimit dhe minimizimin e riskut gjatë zbatimit të kontratës*

#### **ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Projekti teknik, Specifikimet teknike, raportet teknik, preventivi me zerat e punimeve, grafiku janë hartuar nga subjekt projektues të licencuar dhe janë pjesë e DST.**

**Ne çdo rast nese janë përmendur marke prodhimi ose proces i vecante ne dokumentet e tenderit, specifikimet teknike ne kete procedure prokurimi do te pranohen edhe ekuivalent.**

#### **ARGUMENTIMI I KRITEREVE PËRZGJEDHËS PËR KUALIFIKIM**

##### **4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

**A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X**

Sipas rëndësisë:

- |   |              |           |
|---|--------------|-----------|
| 1. <b>Çmimi</b>   | <b>pikët</b> | <b>75</b> |
| 2. <b>Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet)</b> | <b>pikët</b> | <b>10</b> |

- |  |                 |
|--|-----------------|
| 3. <b>Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)</b>  | <b>pikët 10</b> |
| 4. <b>Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)<br/>(jo më pak se 3 %)</b> | <b>pikët 5</b>  |

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

### **Kriteret e vlerësimit:**

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

### **1. Çmimi [0 - 75] pikë**

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

|               |   |
|---------------|---|
| $P_{k1}$      | Pikët e kriterit që vlerësohet                    |
| $V_{\min k1}$ | Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet          |
| $P_{\max k1}$ | Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet |
| $O_{k1}$      | Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet     |

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

### **2. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–10 pikë]**

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryeje. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

***Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:***

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$$

|               |   |
|---------------|---|
| $P_{k3}$      | Pikët e kriterit që vlerësohet                    |
| $V_{\max k3}$ | Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet         |
| $P_{\max k3}$ | Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet |
| $O_{k3}$      | Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet     |

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

### 3. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)

[0 - 10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- *Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:*

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$$

$P_{k4}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k4}$  Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k4}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k4}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

***Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohet nga çdo pagese pjese ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.***

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqese garancine sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

### 4. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)

[0 - 5 pikë]

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqese oferten per vleren PSK ne rubriken specifike/zerin “Siguria ne kantier (Plani I Sigurise e Kordinimit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, date 13.04.2023)”, ne preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur ne mënyrë të posacme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, perfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të vecantë per përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen

aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e vecantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet ne Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrike ne masen jo me pak se 3%, përlogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas percaktimeve të VKM nr. 216 date 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur ne vlerë, në këtë rast jo më pak se **1,135,281.21** leke pa tvsh. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, Aneksi VI “Permbajtja minimale e planit të sigurisë në kantieret e perkoheshme e të levizeshme”.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik per zerin Siguria ne kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit të shtuar), e përfshirë ne oferten ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”

- **Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera 1,135,281.21 lekë pa tvsh.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera 1,135,281.21 leke pa tvsh do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlera 1,135,281.21 leke pa tvsh do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} / V_{\max k2} \times P_{\max k2}$$

$P_{k5}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k5}$  Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k5}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia ne punime: siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social” **nëse vlera e saj do të jetë më shume se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.**

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

$$\begin{aligned} O & \quad - \text{(pikët e Ofertës)} \\ Mo & \quad - \text{Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme} \\ N & \quad - \text{Numri i ofertave të vlefshme} \\ PR (Rrm) & \quad - \text{Rritje e mundshme} \\ Mo & \quad = O_1 + O_2 + O_3 + \dots + O_n / N \\ PR & \quad = 200 \% Mo \end{aligned}$$

Vlera e ofertave të ofruara  $> PR$  ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”.

***Kujdes!!!***

***Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.***

***Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përlllogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.***

*Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.*

*Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK ( $200\% MO = 51,500,000 \text{ leke} < 55,000,000 \text{ leke}$ ) dhe vlerësohet me 0 pike.*

*Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlera per PSK do te jete 55,000,000 leke.*

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlera korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.